



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 01.08.2024

Nr: 156

Ora: 15:36

VENDIM

PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË “KOALICIONI PËR REFORMA INTEGRIM DHE INSTITUCIONE TË KONSOLIDUARA”, PËR AKREDITIMIN E VËZHguesVE PËR VËZHgIMIN E ZGJEDHJEVE TË PJESHME PËR KRYETAR TË BASHKISË HIMARË TË DATËS 4 GUSHT 2024

Sot në datën 01.08.2024, unë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtova kërkesën e:

KËRKUES: “Koalicioni për Reforma Integrim dhe Institucione të Konsoliduara”, me adresë në Rr. Ymer Kurti, Nd. 4, H. 2, 1019 Tiranë;

OBJEKTI: Kërkohet akreditimi si vëzhgues për vëzhgimin e zgjedhjeve të pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë të datës 4 gusht 2024.

BAZA LIGJORE: Nenet 6, 7 e 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”. Vendimi nr. 19, datë 27.01.2023, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, dhe mediave”.

Data: 01.08.2024
Ora: 15:36

Nr: 156



Për miratimin e vëzhguesve, për vëzhgimin e zgjedhjeve të pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë të datës 4 gusht 2024

V Ë R E J:

“Koalicioni për Reforma Integrim dhe Institucione të Konsoliduara” i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën, si dhe dokumentacionin përkatës për akreditimin e 4 vëzhguesve si dhe zonat e vëzhgimit të tyre.

Kërkesa është paraqitur në datën 31.07.2024.

“Koalicioni për Reforma Integrim dhe Institucione të Konsoliduara”, në respektim të nenit 6, pika 2 të Kodit Zgjedhor është një organizatë që gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje.

Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor.

Dokumentacioni shoqëruar i kërkesës është në përputhje me përcaktimet e nenit 6, pika 4 e vijues të Kodit Zgjedhor

PËR KËTO ARSYE:

Si dhe në mbështetje të neneve 6, 7 e 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe vendimit nr. 19, datë 27.01.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, dhe mediave”,

V E N D O S :

1. Akreditimin e 4 vëzhguesve të “Koalicioni për Reforma Integrim dhe Institucione të Konsoliduara” për vëzhgimin e zgjedhjeve të pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë të datës 4 gusht 2024, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 1 (një) dite nga shpallja e tij në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Illirjan CELIBASHI

Data: 01.08.2024 Nr: 156
Ora: 15:36



Për miratimin e vëzhguesve, për vëzhgimin e zgjedhjeve të pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë të datës 4 gusht 2024

Aneksi 1: Lista e Vëzhguesve të Miratuar të “Koalicioni për Reforma Integrim dhe Institucione të Konsoliduara”

	Emri	Mbiemri	Mandati	Seriali	Zona e vëzhgimit
1.	Alketa	Lamani	Afatshkurter	000089	Vlorë
2.	Bledar	Merko	Afatshkurter	000090	Vlorë
3.	Lori	Liko	Afatshkurter	000091	Vlorë
4.	Endri	Abazi	Afatshkurter	000092	Vlorë

Data: 01.08.2024
Ora: 15:36

Nr: 156



Për miratimin e vëzhguesve, për vëzhgimin e zgjedhjeve të pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë të datës 4 gusht 2024